



Unë mbrohem me ligj



Ligji për mbrojtjen e fëmijës

PËRMBAJTJA

Qëllimi i dokumentit.....	4
Përkufizimet.....	5
Parimet e mbrojtjes së fëmijës.....	7
Mbrojtja e fëmijës.....	8
Parandalimi.....	9
Raportimi i rrezikut.....	9
Qasja e shpejtë në drejtësi.....	9
Kujdesi alternativ.....	10
Qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuar (a).....	10
Mbrojtja nga substancat e dëmshme.....	10
Mbrojtja nga klubet e natës dhe lojërat e fatit.....	10
Siguria në masmedia.....	11
E drejta për privatësi.....	11
Ndalimi i rrëmbimit, shitjes dhe trafikimit të fëmijës.....	12
Puna e lejuar dhe e ndaluar për fëmijët.....	12
Edukimi dhe arsimimi.....	13
Shëndeti, jeta, mbijetesa dhe zhvillimi.....	13
Ushqyeshmëria, shëndeti dhe mirëqenia.....	13
Drejtësia në të mirën tuaj.....	13
Ku mund të drejtohem për ndihmë.....	14

Qëllimi i dokumentit

Përshëndetje fëmijë,

A e keni ditur se Kosova ka një Ligj që ju mbron?

Ky ligj i quajtur Ligji për mbrojtjen e fëmijës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2020. Në të njëjtën kohë, shteti dhe organizatat e ndryshme po përpiqen që t'i ndihmojnë të rriturit dhe fëmijët se si ta zbatojnë këtë ligj.

Ligji ka për qëllim t'ju mbrojë nga të gjitha format e dhunës, të cilat mund t'ju pengojnë juve që të rriteni shëndetshëm, të mësoni, të trajtoheni në mënyrë të barabartë dhe të realizoni ëndrrat tuaja! Ky ligj e detyron shtetin dhe të rriturit që të kujdesen dhe të ju mbrojnë juve, pa dallim, duke u bazuar në interesin tuaj më të mirë.

Ky dokument i titulluar “Unë mbrohem me ligj” është krijuar për fëmijët, nga fëmijët-me ndihmën e të rriturve, me qëllim që të ju mbrojë, të mësoni për të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja si qytetarë të vendit tonë.

Përderisa ju mësoni për të drejtat tuaja, kjo ju ndihmon të jeni më të vetëdijshëm se si shoqëria e vendit tonë duhet të zhvillohet në mënyrë të mirëfilltë.

Përmes kësaj, ju ftojmë të mësojmë së bashku!

Me dashuri,

Policia e Kosovës

PËRKUFIZIMET

- **Përkufizim**–shpjegim që jep në mënyrë të përmblodhur përmbajtjen apo kuptimin e diçkaje;
- **Fëmijë**–çdo person nën moshën 18 vjeç;
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (Konventa e OKB)**–lista më e plotë e të drejtave të fëmijëve e krijuar ndonjëherë. Ajo ka 54 nene apo pjesë që përshkruajnë të gjitha të drejtat që duhet t'i kenë të gjithë fëmijët. E përpiluar si Deklaratë mbi të Drejtat e Fëmijës në 1923 nga themeluesja e Save the Children, Eglantyne Jebib. Është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1989, duke njohur rolet e fëmijëve si anëtarë të barabartë të shoqërisë;
- **Ndalimi**: të thuhet që diçka nuk është e lejuar. Kur goditja e fëmijëve është “e ndaluar” në një vend, askush në atë vend nuk lejohet të godasë fëmijët;
- **Fushatë**: përpjekja për të ndryshuar diçka që besoni se është e gabuar;
- **Të drejtat e njeriut**: të drejtat themelore për të cilat njerëzit në mbarë botën dakordohen që i gëzojnë secili individ;
- **Ligji**: një numër rregullash që iu tregojnë njerëzve të një vendi për mënyrën se si duhet të sillen;
- **Joligjore apo e paligjshme**: kundër ligjit;
- **Disiplina pozitive**: një mënyrë jo e dhunshme dhe e respektueshme e rritjes dhe e komunikimit me fëmijë, që inkurajon zhvillim dhe mësim të shëndetshëm;
- **Parandalimi**: ndalimi i diçkaje para se të ndodhë;
- **Mbrojtja**: mbajtja e sigurt e njerëzve ose e gjërave;
- **Shkelja**: nëse “shkelen” të drejtat e ndonjë personi kjo nënkupton se të drejtat e tij nuk janë respektuar;
- **Miratim**: kur diçka pranohet zyrtarisht si e drejtë dhe e lejueshme;
- **Shteti**: mësimdhënësit, mjekët, profesionistët shëndetësorë, policët, gjyqtarët, prokurorët, shërbyesit, zyrtarë dhe institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe komunave përkatëse;
- **Të rriturit**: prindërit/kujdestarët, familjarët dhe anëtarët e komunitetit;
- **Ndihmë juridike**: këshilla ligjore, ndihmë dhe përfaqësim në proceset e drejtësisë. Vlen për personat fëmijë dhe të rritur, të cilët nuk kanë mundësi për të mbrojtur të drejtat e tyre në sistemin e drejtësisë dhe i ndihmon ata persona të përfshihen në proces;
- **Pikëpamja**: mendimi që ka dikush për diçka dhe mënyra se si e vlerëson atë;
- **Diskriminimi**: trajtim i padrejtë dhe jo i barabartë i një personi ose grupi të njerëzve duke u bazuar në prejardhjen e tyre, moshën, gjininë, racën, statusin ekonomik, orientimin seksual, religjionin, aftësinë e kufizuar dhe çfarëdo aspekti tjetër të identitetit;

- **Cenim:** qëllimi për të shkaktuar dhimbje, lëndim, dëmtim ose veprim tjetër armiqësor ndaj dikujt si ndëshkim për diçka të bërë ose të pabërë;
- **Dinjitet:** gjendja ose cilësia e të qenit i/e denjë për nder ose respekt;
- **Dhunë:** veprat ose veprimet me dashje që i bën një person ndaj personit tjetër me qëllim që ta dëmtojë atë;
- **Dhunë psikologjike:** çdo vepër që shkakton ose ka mundësi të madhe të shkaktojë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të një personi;
- **Dhunë fizike:** përdorimi i çfarëdo mjeti për të goditur dhe për të lënduar, shtrëngimi i fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhunë fizike;
- **Ndëshkim trupor:** çdo lloj ndëshkimi që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim tek tjetri si: rrahje, torturë, shkundje, shtyrje, djegie, pickim, çjerrje, kafshim, qortim i rreptë;
- **Lënia pas dore:** mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës;
- **Abuzim:** çdo veprim apo mosveprim, qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit, ose autoriteti që shkakton ose ka gjasa t'i shkaktojë dëm fizik, psikologjik, emocional apo social fëmijës;
- **Keqtrajtimit:** çdo formë e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimit seksual, lënies pas dore apo shfrytëzimit tregtar ose çdo shfrytëzim tjetër që rrezikon shëndetin, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës;
- **Masmedia:** komunikimi me grupe të mëdha të njerëzve, ku informacioni, opinioni, reklama, vepra arti, argëtimi dhe forma të tjera të shprehjes, përcillen tek popullata;
- **Privatësia:** gjendje ku nuk pengoheni nga të tjerët ose nga vëmendja publike. E drejta për të mbajtur sekret informacionin personal ose të njohur vetëm për një grup të vogël njerëzish;
- **Kërkimi i lëmoshës:** kërkimi i ushqimit ose parave si formë e bamirësisë;
- **Trafikimi:** kur blihen ose shiten mallra të paligjshme. Për trafikimin flitet shpesh për “trafikim droge” ose “trafikim njerëzor”. Veprimet e përfshira në trafikim janë të pasigurta, të dëmshme dhe të paligjshme;
- **Konflikti i armatosur:** humbje të rënda të jetëve të njerëzve të paarmatosur, zhvendosje e grupeve të mëdha të njerëzve dhe shkelje e të drejtave të njeriut;
- **Online:** kur kyçesh ose kontrollohesh nga një kompjuter;
- **Institucion:** një organizatë zyrtare e themeluar që ka një rol të rëndësishëm në një shoqëri.

PARIMET E MBROJTJES SË FËMIJËS

1

Interesi më i mirë i fëmijës: në çdo rrethanë ku ju gjendeni, shteti dhe të rriturit detyrohen që t'iu japin përparësi nevojave tuaja individuale dhe të bëjnë atë që është më e mira për ju. Interesi juaj më i mirë sigurohet kur ju keni kontroll të plotë mbi gjendjen tuaj fizike, emocionale, morale dhe kur kjo trajtohet si gjëja më e rëndësishme për mirëqenien tuaj;

2

Mosdiskriminimi: të gjithë ju pa asnjë lloj dallimi, keni të drejtë të trajtoheni në mënyrë të barabartë. Kjo vlen pavarësisht nëse keni një aftësi të kufizuar apo jo, nëse jeni djalë apo vajzë, prej nga vini, çfarë gjuhe flisni, cila është kultura juaj, sa vjet i keni, ku jetoni, cili është religjioni juaj dhe nëse jetoni në familje të varfër apo të pasur.

3

Respektimi i pikëpamjes së fëmijës: kurdo që shteti dhe të rriturit marrin vendime dhe veprime që ju ndikojnë drejtpërdrejt, ju gëzoni të drejtën për të shprehur lirisht pikëpamjet dhe dëshirat tuaja, në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë tuaj. Këtë mund ta bëni vetë ju ose përmes ndonjë përfaqësuesi të përshtatshëm

4

Zhvillimi i aftësive: ju gëzoni të drejtën që të rriteni dhe të zhvillonit aftësitë tuaja. Duke u rritur ju fitoni aftësi të reja për të gjykuar rrethanat tuaja dhe për të marrë vendime.



MBROJTJA E FËMIJËS:

Në Kosovë, në të gjitha ambientet ku mund të ndodheni, ndalohen të gjitha format e dhunës si më poshtë:

Përdorimi i forcës fizike dhe presionit mendor, shkaktimi i ndjenjës së frikës, cenimi i dinjitetit, ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë, përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve, me qëllim të përluljes së personit tjetër, kufizimi i lëvizjeve, tallja, fajësimi, kërcënimi, trembja, diskriminimi, përqeshja, ose forma të tjera jofizike të trajtimit që rrezikojnë mirëqenien tuaj.

Prindërit/kujdestarët e kanë përgjegjësinë kryesore për rritjen dhe sigurinë tuaj. Nganjëherë të rriturit (prindërit/kujdestarët) bashkë me shtetin dhe me juve mund të vendosin për veprimet që do të ndërmerren ndaj jush.

Po ashtu, ligji ka për qëllim që të ndihmojë shtetin dhe të rriturit që të mësojnë disiplinë pozitive të rritjes dhe edukimit tuaj. Mbështetja e të rriturve për të përdorur disiplinë pozitive i ndihmon ata që të zgjidhin konfliktet me ju pa dhunë apo keqtrajtim. Kjo e bën jetën në shoqëri më të mirë për të gjithë.





1

Parandalimi

Ju keni të drejtë që të mos shkoni ose qëndroni në një mjedis dhe me njerëz që nuk janë të sigurt për ju. Të rriturit detyrohen të parandalojnë rrezikun për juve me kohë dhe të sjellin para jush njerëz që mund të ju mbrojnë.



2

Raportimi i rrezikut

Nëse ju ndjeheni në rrezik, ju duhet të raportoni rastin në stacionin më të afërt policor ose në Qendrën për Punë Sociale në komunën tuaj.

Nëse një person tjetër e sheh që ju jeni në rrezik, ai/ajo është i/e obliguar që rastin ta raportojë në Polici ose në Qendrën për Punë Sociale.

Po ashtu nëse një person tjetër ka informata se ju jeni në rrezik, ai/ajo është i/e obliguar ta raportojë në Polici ose në Qendrën për Punë Sociale.



3

Qasja e shpejtë në drejtësi

Në rast se keni qenë të rrezikuar ose keni përjetuar dhunë, ju keni të drejtë të tregoni përjetimin tuaj në një mjedis të sigurt dhe miqësor për ju. Ky mjedis quhet Shtëpia për mbrojtjen e fëmijës. Shteti detyrohet të sjellë të gjithë zyrtarët dhe shërbyesit përgjegjës në këtë shtëpi për të mësuar më shumë rreth rastit dhe për t'ju mbrojtur me kohë.



KUJDESI ALTERNATIV

Ju duhet të jetoni në mjedise ku të tjerët ju mbrojnë, ju mbështesin dhe kujdesen për juve. Nëse prindërit/kujdestarët nuk kanë mundësi të ju ofrojnë njërën nga këto, shteti detyrohet që të gjejë mbështetje për juve.

Ju keni të drejtë të gëzoni kujdes dhe siguri në një shtëpi të mirë, nëse nuk jetoni me prindërit tuaj biologjikë. Shteti detyrohet t'ju vizitojë vazhdimisht për të parë nëse jeni duke jetuar të lumtur dhe të shëndetshëm. Derisa ju rriteni keni më shumë mundësi për të marrë përgjegjësi dhe për të ushtruar të drejtat tuaja.

QASJA E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR/A



Nëse ju keni aftësi të kufizuar/a, ju gëzoni të gjitha të drejtat në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët tjerë. Shteti dhe të rriturit detyrohen që të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për nevojat dhe mirëqenien tuaj.


MBROJTJA NGA SUBSTANCAT E DËMSHME

Përdorimi i substancave të dëmshme për shëndetin tuaj është i ndaluar me ligj. Shteti dhe të rriturit detyrohen të ju mbrojnë që të mos merrni pjesë në përdorimin, prodhimin, shitjen apo shpërndarjen e substancave narkotike, alkoolit, produkteve të duhanit dhe të gjitha produkteve tjera të dëmshme për shëndetin tuaj.

MBROJTJA NGA KLUBET E NATËS DHE HAPËSIRA TË TJERA TË NGJASHME



Juve nuk ju lejohej të shkoni në klubet e natës, lokalet e lojërave të fatit apo të luani online me lojëra të fatit. Shteti dhe të rriturit nuk duhet të lejojnë që ju të shisni apo të blini produkte të rrezikshme për shëndetin tuaj.



Siguria në masmedia

Askush nuk mund të ju detyrojë të shihni ose të angazhoheni në ndonjë video, muzikë, video lojë, faqe interneti apo ndonjë mjet komunikimi që ju rrezikon juve.

Askush nuk lejohet t'ju tregojë, t'ju shesë, t'ju japë me qira ose t'ju shpërndajë materiale (p.sh. libra, fletushka, revista, foto, piktura, video, lojëra etj.) që përmbajnë figura ose përshkrime të organeve seksuale ose aktivitetit seksual, me qëllim që të nxisin kënaqësinë seksuale.

Për t'u njoftuar më shumë rreth efekteve negative të përmbajtjeve të tilla, ju keni të drejtë të informoheni nga televizionet, radiot, portalet, kinematë dhe faqet e internetit në vendin tuaj.

E drejta për privatësi

Çdo fëmijë ka të drejtën e privatësisë. Ju nuk keni nevojë të ndani informatat tuaja personale me këdo që dëshiron ti marrë ato. Informatat personale përfshijnë: emrin, mbiemrin, ditëlindjen, gjininë, vendbanimin, shkollën dhe gjendjen tuaj shëndetësore.

Po ashtu, ju mund të mbani mendimet dhe idetë tuaja private për sa kohë që nuk rrezikohet mirëqenia juaj ose nuk i shkakton dëm askujt.

Shteti dhe të rriturit duhet të mësohen se si të mos ndajnë me të tjerët informatat tuaja personale, gjithmonë duke respektuar dinjitetin tuaj. Askush (duke përfshirë shtetin), nuk mund të përfshihet në familjen tuaj, përveç rastit kur ligji obligon përfshirjen e tyre për të ju mbrojtur juve.



Ndalimi i rrëmbimit, shitjes dhe trafikimit të fëmijës

Askush nuk ka të drejtë t'iu rrëmbejë apo t'iu trafikojë juve. Shteti dhe të rriturit detyrohen t'ju mbrojnë që të mos rrëmbeheni nga ndonjë person, duke përfshirë prindërit ose njerëzit që kujdesen për juve. Për asnjë qëllim ose në çfarëdo forme, askush nuk ka të drejtë t'ju detyrojë të kërkonin ushqim, para apo ndonjë gjë tjetër.

Puna e lejuar dhe e ndaluar për fëmijët

Ky ligj ju mbron juve që të mos angazhoheni në punë të rënda dhe të rrezikshme.

Asnjë punë nuk duhet t'iu pengojë kohën për mësim, për të shkuar në aktivitete ku fitoni aftësi të reja apo për të pushuar.

Nëse ju jeni 15 vjeç deri në 18 vjeç, ju mund të punoni vetëm punë të lehta, të cilat nuk e dëmtojnë sigurinë, shëndetin ose zhvillimin tuaj.

Çdo punë e fëmijës, e paguar apo e papaguar, punë vullnetare, praktikë dhe angazhim në komunitet, mund të lejohet vetëm në bazë të lejes së prindit/kujdestarit tuaj. Edhe kur lejohet, të rriturit detyrohen që të vlerësojnë dhe mbikëqyrin vazhdimisht sigurinë tuaj.

Ndërsa shteti dhe të rriturit duhet t'ju mbrojnë nga format e rënda dhe të rrezikshme të punës, të cilat nuk lejohen për asnjë moshë të fëmijëve. Ato forma përfshijnë: shfrytëzimin nga të rriturit për përfitime të tyre (p.sh. kërkimi i lëmshës, trafikimi, angazhimi në aktivitete seksuale), prodhimi, përdorimi, shpërndarja dhe shitja e substancave narkotike dhe alkoolit, angazhimi në konflikt të armatosur ose luftë.





Edukimi dhe arsimimi

Ky ligj ndalon këdo që t'iu cenojë të drejtën për edukim dhe arsimim. Secili prej jush duhet të ketë qasje në edukim dhe arsimim, pavarësisht rrethanave tuaja në familje dhe shoqëri. Kopshtet, shkollat dhe të gjitha qendrat mësimore duhet të jenë vende të sigurta për juve dhe të gjithë të rriturit që punojnë aty duhet të ju trajtojnë në mënyrë të sigurt.

Shëndeti, jeta, mbijetesja dhe zhvillimi

Ju keni të drejtë që të rriteni të shëndoshë. Shteti dhe të rriturit duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur që foshnjat dhe fëmijët të mos vdesin.

Shteti duhet të sigurohet që të ketë qendra të mjekësisë familjare dhe spitale afër jush, që ato të ofrojnë kujdes cilësor dhe që ju të mos paguani për ato shërbime. Po ashtu, shteti duhet të sigurohet që profesionistët shëndetësorë t'ju vizitojnë në shtëpi, për të kuptuar nevojat tuaja shëndetësore. Askush nuk ka të drejtë që të ndajë me të tjerët informatat rreth shëndetit tuaj, përpos nëse kjo është e domosdoshme.

Ushqyeshmëria, shëndeti dhe mirëqenia

Ju keni të drejtë që të ushqeheni shëndetshëm dhe të informoheni nga të rriturit se cilat ushqime janë të mira për juve.

Shteti dhe të rriturit detyrohen t'ju ofrojnë ujë të pastër të pijes, mjedis natyror të pandotur dhe mjedise tjera pa aksidente. Po ashtu, shteti duhet të sigurohet që nënat/kujdestaret tuaja të jenë të shëndetshme, para dhe pasi të lindin foshnjat e tyre.

Drejtësia në të mirën tuaj

Shteti dhe të rriturit detyrohen të ju trajtojnë me respekt edhe nëse keni kryer ndonjë vepër joligjore. Për shkak të moshës dhe zhvillimit tuaj, pavarësisht se çfarë vepre keni bërë, shteti e zbaton drejtësinë në interesin tuaj më të mirë.

Shteti detyrohet t'ju ofrojë një mjedis të sigurt dhe miqësor përderisa ju i shpjegoni rrethanat e veprimit tuaj joligjor. Po ashtu shteti detyrohet të ju mbështesë që ta tejkaloni atë situatë përmes ndonjë aktiviteti që i ndihmon komunitetit tuaj.

Në rast nevojë, ju gëzoni të drejtën për ndihmë juridike falas nga shteti.

Ku mund të drejtohem për ndihmë?

Kurdo që ndiheni të rrezikuar, ju mund të raportoni tek shteti i cili ju mbrohet juve përmes Policisë së Kosovës dhe Qendrës për Punë Sociale në komunën tuaj. Ata janë të gatshëm për ju në çdo kohë dhe kudo që ndodheni.

Policia e Kosovës– ka për detyrë t’ju ndihmojë dhe të ju mbrojë juve, familjen tuaj dhe të gjithë njerëzit e komunitetit tuaj. Fillimisht Policia e Kosovës do t’ju dëgjojë juve për atë që ju ka ndodhur dhe pastaj do të mundohet të bashkëpunojë me shtetin dhe të rriturit për t’ju ndihmuar. Ju mund të kontaktoni Policinë e Kosovës në çdo kohë në numrin e telefonit 192 i cili është pa pagesë.

Qendra për Punë Sociale– ka për detyrë të ju ndihmojë dhe të kujdeset për juve dhe të rriturit, të cilët janë të pambrojtur ose të cilët nuk mund të gjejnë ndihmë për nevojat e tyre. Punëtorët socialë janë të rriturit që punojnë në këto qendra në komunën tuaj.

Gjithashtu janë edhe disa grupe të tjera të zyrtarëve të shtetit, të cilët ndajnë përgjegjësi të barabarta për t’ju mbrojtur juve. Këto grupe ju mbrojnë, duke u siguruar se të drejtat tuaja respektohen dhe zbatohen si në familje ashtu edhe në shkollë, qendra mësimore, spitale, qendra të mjekësisë familjare dhe në komunitetin tuaj.

Këto grupe quhen “**Këshilli për të Drejtat e Fëmijës**”, i cili përbëhet nga zyrtarët që punojnë për shtetin në nivel vendi dhe “**Ekipi për të Drejtat e Fëmijës**”, i cili përbëhet nga zyrtarët që punojnë në nivel komunal. Këto grupe mblidhen disa herë në vit për të diskutuar nëse institucionet po ju përmbahen obligimeve dhe planeve të shtetit për mbrojtjen dhe sigurinë tuaj.



KONTAKTO POLICINË E KOSOVËS

Nga telefonio fikse dhe mobile:

192

ose 038 550 999

NA NDIQNI NË FACEBOOK DHE TWITTER

www.kosovopolice.com
www.facebook.com/KosovoPolice
twitter.com/Kosovo_Police
info@kosovopolice.com
Applikacioni lajmëro Policinë



UNË MBROHEM ME LIGJ